

AGJENDA E KONTRATËS SOCIALE PËR KOMUNËN E GJAKOVËS

HYRJE

Komuna e Gjakovës dhe qytetarët e saj zotohen të zbatojnë Agjendën e Kontratës Sociale të dakorduar nga përfaqësuesit e të dyja palëve për të përmirësuar komunikimin dhe bashkëpunimin midis qytetarëve dhe zyrtarëve të komunës

Qëllimet e Agjendës janë të:

- mbështetë bashkëpunimin e hapur, të sigurtë dhe domethënës midis zyrtarëve komunal dhe qytetarëve për të zgjidhur çështjet e banorëve;
- ndihmojë qytetarët dhe zyrtarët komunal që të kuptojnë më mirë përgjegjësitë dhe kontributin e njëri-tjetrit;
- inkurajojë respektin për diversitetin e përvojave dhe mendimeve ndërmjet qytetarëve dhe zyrtarëve të komunës dhe
- ndërtojë besimin midis qytetarëve dhe zyrtarëve të komunës.

ÇËSHTJET E KOMUNITETIT QË DUHET TË ADRESOHEN BASHKËRISHT NGA QYTETARËT DHE ZYRTARËT KOMUNAL NË GJAKOVË

Çështja 1: Biçikleta me qira në zona publike

Përshkrim i çështjes: Qytetarët e Gjakovës identifikuan nevojën për të pas opsionin e marrjes me qira të biçikletave, si mjet alternativ të transportit dhe si një metodë e përshtatshme për turistë vendor të eksplorojnë qytetin. Këta qytetarë kanë konstatuar që po të kishte qasje më të lehtë në biçikleta, përdorimi i tyre do të rritej sepse do të nxiste qytetarët e komunës, sidomos të rinjtë, që të shfrytëzonin më shumë biçikletat për transport nëpër qytet për punë ditore si dhe transport në vende si parku i Shkugëzës. Po ashtu, qytetarët e Gjakovës dhe turistët do të mund ta eksploronin qytetin, parkun e Shkugëzës dhe pikat tjera turistike në zonat rurale të komunës. Duke marrë parasysh numrin e turistëve që sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, çdo vit është në rritje e sipër, rëndësia e këtij opsioni të transportit vetëm sa rritet. Rritja e numrit të përdoruesve të biçikletave si mjet transporti në komunën e Gjakovës do të ndikonte në shkarkimin e trafikut, parandalimin e ndotjes së mjedisit dhe shëndetin më të mirë të qytetarëve.

Prandaj është propozuar që të ofrohet mundësia e ofrimit të biçikletave me qira si opsion i cili do të ndikonte pozitivisht në promovimin e shfrytëzimit të metodave tjera të transportit, që fokus primar do të ketë turistët të cilët vizitojnë Gjakovën, por edhe qytetarët e Gjakovës në përgjithësi.

Një numër biçikletash do të ofrohen për përdorues në një ose dy lokacione të cilat pritet të përcaktohen nga qytetarët, në bashkëpunim me komunën. Marrja me qira do të mundësohet përmes një aplikacioni ose përmes një organizate si Këshilli Lokal i Veprimit Rinor (KVRL) apo kompanive të sigurisë të kontraktuara nga komuna në zonën qendrore të parkimit. Lokacionet e propozuara të përmendura në fazën e planifikimit të veprimit janë: “Pallati i Kulturës” ku gjinden edhe kamerat dhe roje sigurie; Zyra Informativ Turistike ku ndodhet KVRL (një organ që mund të jetë përgjegjës për menaxhimin e qirave të biçikletave).

Qëllimi: Zhvillimi i mjeteve alternative të transportit publik për banorë dhe vizitorë, si dhe krijimi i një mjedisi urban më të shëndetshëm për jetesë

Grupet e ndikuara: Turistët që vizitojnë Gjakovën, Shoqata e Çiklizmit, Zyra Informativ Turistike, të rinjtë, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, dhe të gjithë qytetarët.

Hapi 1: Vlerësimi i kërkesës për biçikleta

Hapi 1: Vlerësimi i kërkesës për biçikleta	Përgjegjësia	Afati kohor
- Grupet e qytetarëve vlerësojnë më thellësisht nivelin e kërkesës për biçikleta për turistë dhe qytetarë.	OJQ-të e çiklizmit dhe OJQ tjera, Organizatat Rinore, qytetarët tjerë	Maj 2024
- Komuna rishikon dhe përditëson strategjitë ekzistuese që rregullojnë shtigjet e biçikletave.	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Shërbimeve Publike	Maj 2024
Hapi 2: Identifikimi i lokacionit/eve	Përgjegjësia	Afati kohor

- Qytetarët propozojnë lokacionet me qasje të lehtë ku do të vendosen biçikletat.	OJQ-të e çiklizmit dhe OJQ tjera, Organizatat Rinore, qytetarët tjerë	Qershor 2024
- Komuna shqyrton qasjen dhe mundësinë e shfrytëzimit të lokacioneve të propozuara si dhe jep lejen për shfrytëzim të lokacionit/ve të identifikuar. -Konsultimi me specialistin e planifikimit urban për lokacionet e propozuara.	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Drejtoria e Shërbimeve Publike	Qershor 2024
Hapi 3: Zhvillimi i projekt propozimit	Përgjegjësia	Afati kohor
- Shoqata e çiklistëve dhe KVRL ndihmon në hartimin e projekt propozimit. Projekt propozimi përfshin edhe specifikat teknike të biçikletave dhe koston e tyre si dhe të realizimit të projektit në përgjithësi. - Shqyrtohet edhe mundësia e krijimit të një aplikacioni mobil, lidhur me hartat që determinojnë vendndodhjen dhe pagesën me rastin e shfrytëzimit.	Shoqata e çiklistëve, shoqata tjera relevante, Këshilli i Veprimit Rinor Lokal – KVRL, qytetarët tjerë	Korrik -Gusht 2024
- Komuna përcakton drejtorinë/zyrtarin përkatës që do të ndihmojë në sigurimin e informatave dhe ekspertizës. Pastaj bëhet shpallja e tenderit. - Komuna mbështet qytetarët me informata dhe ekspertizë. Mund të angazhohen ekspertë të jashtëm (zhvillues aplikacionesh, planifikues urban, specialist mjedisor) në rast se komuna nuk e ka ekspertizën e nevojshme. - Organizimi i një dëgjimi publik me profesionist të IT-së dhe bizneseve që të kontribuojnë në realizimin teknik dhe zbatimin e çështjes së komunitetit.	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik;	Korrik – Gusht 2024
Hapi 4: Zbatimi i projektit dhe promovimi	Përgjegjësia	Afati kohor
- Drejtoria për Zhvillim Ekonomik (Zyra për Turizëm) përcakton kriteret për përzgjedhjen dhe dhënien e menaxhimit të projektit të biçikletave me qira. Promovimi i çështjes do të bëhet përmes fushatave, fotove, videove, ngjarjeve publike, përdorimit të mediave sociale, krijimit të grupeve dhe forumeve përmes metodave të komunikimit online (viber, whatsapp)	Shoqata e çiklistëve, shoqata tjera relevante, Këshilli i Veprimit Rinor Lokal – KVRL, qytetarët tjerë	Shtator – Tetor 2024
- Komuna do të ndihmojë me promovim në faqen zyrtare dhe në media sociale si dhe përmes mediave lokale. Zhvillimi i një videoje të stories së suksesit që tregon çështjet e komunitetit që nga fillimi i saj deri në zbatim, duke përfshirë bashkëpunimin në mes të qytetarëve dhe zyrtarëve komunalë për të inkurajuar përpjekjet e ardhshme të bashkëpunimit për të adresuar çështjet e komunitetit.	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik; Drejtoria e Shërbimeve Publike	Nëntor, 2024

Çështja 2: Shenjëzimi i shtigjeve malore
<p>Përshkrim i çështjes: Qyteti i Gjakovës është i rrethuar me shtigje malore të cilat fillojnë nga parku i Shkugëzës ku përfundon pjesa e urbanizuar e qytetit dhe vazhdojnë në malësi deri në kufi me Shqipërinë.</p> <p>Këto shtigje përfshijnë: shtigjet për ecje brenda Parkut të Shkugzës - 4 km; Shtegu Brekoc - Devë - 6.5 Km; Shtegu Çabrat - Jahoc - 2.4 Km; Shtegu Shkugëz-Vaska e Currilave-Shpella e Kusarit - 6 Km dhe Shtegu Kanion -Drini i Bardhë - 900 m. Këto shtigje kryesisht shfrytëzohen nga alpinistët lokal të cilët e njohin mirë terrenin. Por shfrytëzimi i këtyre shtigjeve për pjesën dërmuese të qytetarëve është i vështirë për shkak se nuk janë të shënjestruara si duhet.</p> <p>Disa grupe të qytetarëve të Gjakovës kanë shprehur nevojën e bashkëpunimit të institucioneve komunale që këto shtigje të shënjestrohen që të gjithë qytetarët të kenë qasje të njëjtë që të mund të shijojnë natyrën.</p>

Përveç që do të ju shërbejnë banorëve të Gjakovës, shtigjet e shënjestuara pritet të tërheqin një numër në rritje të turistëve që vizitojnë komunën, duke pasur parasysh vendndodhjen afër “Alpeve Shqiptare”. Shënjestimi i shtigjeve ka potencial për të rritur numrin e vizitorëve dhe bashkëpunimin e fshatrave përreth me fshatrat që ndodhen në zonën malore të Shqipërisë. Gjithashtu, kjo iniciativë do të rrisë ndërgjegjësimin e qytetarëve për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe promovimin e aktiviteteve sportive dhe rekreative në komunën e Gjakovës.

Para se të fillohet me shënjestimin e tyre, shoqatat e alpinistëve dhe çiklistëve do të bëjnë një vlerësim të shtigjeve ekzistuese duke përfshirë matjen e tyre si dhe vlerësimin e gjendjes ekzistuese përfshirë edhe lehtësinë e qasjes tek këto shtigje. Më saktësisht do të bëhet edhe emërimi i majave të bjeshkëve që e rrethojnë Gjakovën me malësinë e Shqipërisë. Mendohet që shtigjet të shënjestohen me ngjyra. Tabelat orientuese me emërtime të majave do të jenë të vendosura në shtylla të hekurit në mënyrë profesionale nga materiali i fortë dhe i qëndrueshëm ndaj kushteve atmosferike.

Qëllimi: Krijimi i mundësive për aktivitete rekreative dhe shfrytëzim jo vetëm nga qytetarët e Gjakovës por edhe nga vizitorët.

Grupet e ndikuara: Vrapuesit, çiklistët dhe qytetarët tjerë të Gjakovës, përfshirë edhe turistët që vizitojnë Gjakovën, shoqatat e ndryshme rinore, Shoqata Bjeshkatore Alpiniste “Pashtriku”, banorët e fshatrave përreth, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik.

Hapi 1: Identifikimi i grupeve të interesit	Përgjegjësia	Afati kohor
- Takim konsultativ me të gjitha palët e interesit përfshirë edhe: Këshillin lokal, Shoqatën e bjeshkatarëve, OJQ “Një thes me vete”, OJQ “Mountain bike”, grupin e vrapuesve, Drejtorinë për Zhvillim ekonomik dhe Zyrën e turizmit	Shoqata e Alpinistëve	Maj 2024
Hapi 2: Vlerësimi dhe matja e shtigjeve	Përgjegjësia	Afati kohor
- Shoqata alpiniste do të matë shtigjet me pajisje të GPS.	Shoqata e Alpinistëve	Maj 2024
- Konsultime me njësinë e komunikacionit për vendosjen e tabelave për shenjëzim.	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik Drejtoria e infrastrukturës	Maj 2024
Hapi 3: Dizajnimi i projekt propozimit	Përgjegjësia	Afati kohor
- Projekti do të përfshijë informacion rreth shtigjeve duke përfshirë matjet e shtigjeve si dhe specifikimet për sinjalistikën (pllakat orientuese për ecje).	Shoqata e Alpinistëve	Qershor 2024
- Mbështetje me ekspertizë në specifikimet teknike të projektit.	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	Qershor 2024
Hapi 4: Zbatimi i projektit	Përgjegjësia	Afati kohor
- Vendosja e pllakave informuese dhe orientuese.	Shoqata e Alpinistëve	Korrik 2024
- Përfshirja e shtigjeve në harta digjitale	Drejtoria e infrastrukturës	Korrik-Shtator 2024
Step 5: Promovimi i shtigjeve	Përgjegjësia	Afati kohor
- Promovimi i shtigjeve me ekran digjital.	Shoqata e Alpinistëve, OJQ “Një thes me veti”, OJQ “Mountain bike”, grupi I vrapuesve, këshilli lokal,	Korrik 2024
- Video promovuese ku ftohen qytetarët të përdorin shtegun.		
Hapi 6: Inaugurimi dhe promovimi i shtigjeve tek komuniteti dhe agjencitë turistike	Përgjegjësia	Afati kohor
- Promovimi i shtigjeve malore përmes broshurave	Zyra e turizmit	Korrik-Gusht 2024
- Përrurimi i shtigjeve përmes një shëtitjeje të organizuar për të gjithë qytetarët e Gjakovës (përfshirë sportistët, njerëzit me ndikim etj.).	Shoqata e Alpinistëve, OJQ “Një thes me veti”, OJQ “Mountain bike”, grupi I vrapuesve, këshilli lokal, Drejtoria e infrastrukturës,	Shtator 2024

ZOTIMET PËR PËRMIRËSIMIN E PRAKTIKAVE TË PJESËMARRJES

Takime publike dhe dixhitalizimi i kërkesave të qytetarëve		
Qëllimi: Të rritet gjithë-përfshirja në qeverisje dhe të përdoren më shumë mekanizmat digjital për komunikim, mbledhjen dhe trajtimin e kërkesave të qytetarëve.		
Takime publike me grupe më pak të përfaqësuara	Përgjegjësia	Afati kohor
-Organizimi i takimeve publike me grupe më pak të përfaqësuara (gra, komunitetin Egjiptas, Rom, Ashkali dhe dhe të rinj) me ftesa më inovative, tema specifike, lokalitete dhe orare të përshtatshme, me përfshirjen dhe përkrahjen e grave asambliste dhe komitetit për barazi gjinore.	Kuvendi i Komunës, Zyra për Informim dhe Drejtoritë komunale	Maj 2024- Gusht 2025
- Qytetarët identifikojnë problemet dhe ia komunikojnë komunës. Komuna gjen një vend të përshtatshëm për të diskutuar kërkesën me qytetarët dhe fton grupe të ndryshme banorësh si: grupet e nën përfaqësuara, gratë, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara, qytetarët nga komunitetet jo shumicë, si dhe organizatat joqeveritare dhe bizneset duke ndikuar kështu në këto grupet për të marrë pjesë në mbledhjet komunale. -Storie suksesi që tregojnë se çfarë hapa duhet të ndërmarr një qytetari për të ngritur një çështje tek komuna, dhe si i adreson komuna kërkesat e qytetarëve që të nxiten edhe të tjerët për adresimin e kërkesave.	Shoqatat e grave, OJQ-të e të rinjve, aktivistët e komunitetit Egjiptas, Rom dhe Ashkali, Handikos Gjakova, Këshillat Lokal.	Maj 2024- Gusht 2025
Menaxhimi i kërkesave në mënyrë digjitale	Përgjegjësia	Afati kohor
- Përpilimi dhe shpërndarja e një raporti që përfshin komentet e ofruara nga qytetarët në takime publike dhe që regjistron kërkesat e qytetarëve në sistemin e komunës për menaxhimin e kërkesave.	Zyra për Informim dhe Drejtoritë komunale;	Shtator 2024

Praktikimi i i buxhetimit me pjesëmarrje		
Qëllimi: Avancimi i dëgjimeve buxhetore sa i përket aspekteve organizative, logjistike, si dhe ndërvepruese me qytetarë.		
Buxhetimi me pjesëmarrje	Përgjegjësia	Afati kohor
- Realizimi i buxhetimit me pjesëmarrje me më së paku 5% të buxhetit të investimeve kapitale në pesë zona dhe zgjerimi në lagje/fshatra tjerë në vitet e ardhshme. Komuna do të përzgjedh kriteret për projektet e buxhetimit me pjesëmarrje dhe lokalitetet për të pilotuar metodën e buxhetimit me pjesëmarrje për vitin e parë me qëllim të zgjerimit të kësaj praktike edhe në vitet e ardhshme. - Përpilimi dhe realizimi i një plani të komunikimit për informimin e publikut rreth procesit të buxhetimit me pjesëmarrje.	Zyra për Informim dhe Drejtoria komunale për buxhet dhe financa	Maj 2024- Gusht 2025
- Grupet e qytetarëve dhe OJQ-të promovojnë (përmes kanaleve të komunikimit digjital Viber kanaleve, Facebook, ueb-faqeve të ndryshme, komunikimit fizik etj), metodën e buxhetimit me pjesëmarrje në lokalitet e përcaktuara ku pilotohet dhe lokalitet tjera që të ngritet niveli i vetëdijes për këtë lloj të pjesëmarrjes dhe vendimmarrjes së qytetarëve për projektet e financuara nga komuna. -Grupet e qytetarëve dhe OJQ-të e ndryshme si: organizatat e të moshuarve, shoqatat e grave, etj zotohen të realizojnë sesione informuese për lokalitetet ku mbahet buxhetimi me pjesëmarrje.	Qytetarët dhe OJQ-të	Maj 2024- Gusht 2025

Fuqizimi i rolit të Këshillave Lokal		
Qëllimi: Këshilla Lokal gjithëpërfshirës dhe funksional të aftë të komunikojnë dhe organizojnë lagjen dhe fshatin që përfaqësojnë, për adresimin e kërkesave prioritare tek komuna.		
Së paku katër takime me kryetarët e këshillave lokal për t'i mbajtur ata të informuar për projektet dhe planet komunale	Përgjegjësia	Afati kohor
<ul style="list-style-type: none"> - Koordinator i këshillave lokal mban takime me kryetarët e këshillave lokal në baza tremujore për t'i informuar ata për projektet kapitale të planifikuara (në fillim të çdo viti), procesin buxhetor dhe planin e dëgjimeve buxhetore dhe buxhetimin me pjesëmarrje (përpara se të publikohet qarkorja e parë buxhetore), investimet kapitale të miratuara nga Kuvendi për vitin e ardhshëm (pas miratimit të buxhetit) dhe statusin e kërkesave të tyre (në fund të vitit). - Koordinator duhet të gjejë mënyra për të stimuluar dhe inkurajuar kryetarët e këshillave lokal që të takohen më rregullisht me banorët, përfshirë gratë dhe të rinjtë, duke organizuar takime më sociale dhe më pak formale. 	Koordinatori i Këshillave lokal (Zyra e Administratës).	Qershor 2024 Tetor 2024 Mars 2025 Qershor 2025 Tetor 2025
<ul style="list-style-type: none"> - Kryetarët e këshillave lokal zotohen të marrin pjesë në mbledhje, të mësojnë për buxhetin e komunës dhe kufizimet e stafit. - Kryetarët inkurajojnë edhe anëtarët e tjerë të këshillit, veçanërisht gratë dhe të rinjtë që të marrin pjesë aktive në mbledhje. 	Kryetarët e Këshillave Lokal	Qershor 2024 Tetor 2024 Mars 2025 Qershor 2025 Tetor 2025
Promovimi i pjesëmarrjes më të madhe të grave dhe të rinjve në strukturat e këshillave lokal	Përgjegjësia	Afati kohor
<ul style="list-style-type: none"> - Kryetarët e këshillave lokal dhe koordinatori për këshillat lokal duhet të organizojnë sesione informuese me gratë dhe të rinjtë dhe të inkurajojnë angazhimin e tyre më të madh. 	Zyra e Administratës, Koordinator i Këshillave lokal	Maj 2024-Gusht 2025
<ul style="list-style-type: none"> - Sesione informuese “Shpërndani fjalën” me gratë dhe të rinjtë, veçanërisht në zonat urbane për t'u bërë pjesë e strukturave vendimmarrëse të këshillave lokal dhe për të promovuar rolin e tyre në komunitet. - Identifikimi i nevojave të qytetarëve para mbajtjes së sesioneve informative. - Organizimi i këtyre sesioneve informative duhet të bëhet përmes një fushate vetëdijësuese duke theksuar rëndësinë e angazhimit qytetar. 	Këshillat Lokal, Shoqata e pensionistëve, Zyra për komunitete dhe kthim , YMCA, Handikos Gjakovë.	Maj 2024-Gusht 2025

Mirënjohje jo-financiare për qytetarin dhe zyrtarin aktiv		
Qëllimi: Themelimi i sistemit të mirënjohjes jo financiare për qytetarët/organizatat dhe zyrtarët komunalë aktiv përmes një procesi nominimi që të inkurajohen veprimet e shërbimit publik.		
Ndarja e mirënjohjes jo financiare për zyrtarë dhe qytetarë aktiv	Përgjegjësia	Afati kohor
<ul style="list-style-type: none"> - Vendimi për formimin e komisionit me përbërje diverse përmes faqes zyrtare si dhe rrjeteve sociale. 	Zyra për Informim dhe Drejtoria e Administratës	Nëntor 2024
<ul style="list-style-type: none"> - Paraqitja e propozimeve dhe nominimeve dhe shpërndarja e informatave për procesin e nominimit për përzgjedhjen e qytetarëve apo organizatave aktive si dhe nominimin e zyrtarëve komunalë. 	KVRL, Këshillat Lokal	Nëntor 2024

Kjo Agjendë e Kontratës Sociale u dakordua nga zyrtarët e Komunës së Gjakovës dhe përfaqësues të komunitetit në një proces të lehtësuar dhe të mbështetur nga Aktiviteti i USAID-it “Kontrata Sociale” gjatë periudhës Janar - Mars 2024. Zyrtarët komunal dhe përfaqësuesit nga grupe të qytetarëve dhe grupe të ndikuara zotohen të zbatojnë veprimet e sipërpërmendura brenda një

periudhe prej 18 muajsh. Zyrtarët komunal dhe grupet e qytetarëve zotohen të takohen në baza tre mujore për të monitoruar progresin e kësaj Agjende të Kontratës Sociale.